



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 932/ Prot.

Vlorë më, 02.04.2026

VENDIM

Nr. 18, datë 02.04.2026

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË
DHE AKREDITIMIT NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.09.2018 dhe ndryshuar me VKM nr. 824, datë 24.12.2021; të nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 13, pika 22 të Rregullores së Brendshme të UV-së; Planit Strategjik 2025–2030 të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe duke iu referuar shkresës nr. 675 prot., datë 10.03.2026, të Sektorit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin nen për nen dhe në tërësi të Rregullores së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Sektori i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit dhe njësitë përkatëse akademike dhe administrative për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim i përcillet Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, për shpallje në faqen web të vendimit dhe për realizimin e njoftimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ

